



Instituti i Kërkimeve Urbane

## ADVOKIM PËR FONDE PËR SEKTORIN E BUJQËSISË

**Kohëzgjatja:** 2008

**Financuar nga:** Oxfam ( [www.oxfam.org](http://www.oxfam.org) )

**Partneritet:** Lëvizja Europiane në Shqipëri (antare e Lëvizjes Europiane [www.europeanmovement.eu](http://www.europeanmovement.eu) )

IKU në bashkëpunim me Lëvizjen Europiane në Shqipëri ka hartuar një raport studimi që ofron të dhëna dhe informacion për mënyrën se si influencon procesi i përgatitjes dhe zbatimit të Buxhetit mbi varfërinë në nivel lokal. Bazuar mbi të dhënat e studimit, IKU dhe EMA kanë ndërmarr një set aktivitetesh për ngritjen e një modeli advokimi, në nivel qendror dhe lokal, për një vëmendje më të veçantë për alokimin e fondeve në sektorin e bujqësisë.

Shqipëria ka një ekonomi që mbështetet mbi zhvillimin rural, dhe megjithëse ky sektor ka një kontribut prej 25 % të PPB përsëri karakterizohet nga një alokim fondesh prej 0.8 % nga buxheti total. Gjatë projektit u synua zhvillimi dhe përforsimi i një bashkëpunimi të afërt me përfaqësues nga politikë bërësit dhe vendim marrësit si Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministria e Financës etj për të bashkërenduar përpjekjet për advokim dhe lobim për një rritje të buxhetit që alokohet për bujqësinë. Gjithashtu ky projekt synoi dhe sensibilizimin dhe mbështetjen e pjesëmarrjes qytetare nga komuniteti rural në procesin e përgatitjes së buxhetit si dhe adresimin e bujqësisë si një prioritet në strategjitë kombëtare për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomisë dhe mirëqenie.

Aktivitetet kryesore që u ndërmorën për përgatitjen e këtij raport studimi janë si më poshtë:

- ***Kryerja e një analize krahasuese të buxhetit rural dhe zbatimit të tij për 2007-2008***, aktorët kryesorë të përfshirë si dhe kuadrin ligjor regulator në bashkëpunim me institucionet përgjegjëse.
- ***Ofrimi i argumentave dhe rritja e ndërgjegjësimit*** për shoqërinë civile dhe median për të lobuar për një alokim dhe përdorim më të mirë të fondeve për sektorin e bujqësisë (aktivitete advokimi si takime publike, konferenca shtypi etj).
- ***Përdorim i informacionit për eksperiencat më të mira ndërkombëtare*** për dizenjimin dhe menaxhimin e buxhetit rural për ta përshtatur për kushtet e Shqipërisë.
- ***Përgatitja e një seti rekomandimesh për ndryshime të buxhetit*** që adresojnë zhvillimin makroekonomik me fokus zhvillimin e bujqësisë që përfshin: një sistem informimi dhe raportimi që nxit vendim marrje efektive dhe përfshirjen e indikatorëve të performancës që lejojnë analizën e trendit dhe krahasimet ndër institucionale.
- ***Krijimi i lidhjes së buxhetit lokal dhe kombëtar me rezultatet e pritshme*** që mbështetin zhvillimin e bujqësisë.

Ky raport studimi i mbështetur me aktivitete të rritjes të ndërgjegjësimit kontribuojnë në një rritje të buxhetit të alokuar për bujqësinë duke sjell përfitime për:

1. Përfshirjen e shumë aktorëve të interesit në procesin e vendimmarrjes duke përmirësuar planifikimin e buxhetit, shpenzimeve dhe të ardhurave për këtë sektor.
2. Më shumë vende pune për veçanërisht popullsinë në zonat rurale dhe përmirësimin e kushteve të jetesës.
3. Rritje e prodhimit bujqësor të në Shqipëri për të furnizuar më mirë tregun dhe për të luftuar konkurrencën e çmimeve të produkteve të importuara.